



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2024:012958

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05740045

**C.nr.280/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.M. me numër personal ..... nga fshati Lubinjë e Poshtme, komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqësojnë av. A.A. dhe Z.S. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson, përfaqësuesja ligjore e Komunës V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit 544.00 euro, jashtë seance, me datë **27.05.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.M. nga fshati Lubinje e Poshtme, komuna e Prizrenit. **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditëses në emër të shujtave ditore për 271 ditë pune, (për periudhën prej datës 19.04.2021 deri më datën 21.11.2022) ti paguaj **shumën e përgjithshme prej 542.00 euro**, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm
- II.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit M.M. në emër të kompensimit të shujtave ditore për datën 22.11.2022 në shumën prej 2.00 €, **refuzohet si e pabazuar.**
- III. DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **124.00 euro**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm

**A r s y e t i m**

Paditësit M.M. nga fshati Lubinje e Poshtme, komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij av. A.A. pranë kësaj gjykate, me datën 12.01.2024, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave.

Të autorizuarit e paditësit, në padi kanë theksuar se paditësit është i punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në vendin e punës punonjës të arsimit në SHFMU “25 Maj” në fshatin Lubinje e poshtme, komuna e Prizrenit. I plotëson kushtet e përfitimit të shujtës ditore sipas kushteve të parapara me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, për ditët e pranisë në punë, duke kërkuar kështu kompensimin për periudhën 2021/22, sipas vërtetimeve të lëshuara nga drejtoria e shkollës. Pasi që e paditura, deri në paraqitjen e padisë nuk ia ka paguar kompensimin për ushqim gjatë punës këtu paditësve, gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësve ta aprovon në tërësi si të bazuar.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, lidhur me kompensimin e shujtave ditore. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar E njëjta ka theksuar se pretendimet e paditësve se iu takon kompensimi i shujtave ditore është në kundërshtim me nenin 2 par.1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, pasi përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë që janë anëtar të sindikatës. Të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 dhe datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësve është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht janë mësimdhënës pranë SHFMU “25 Maj” në fshatin Lubinje e Poshtme, komuna e Prizrenit

Nga vërtetimi me numër të referencës 1172023, të datës 21.12.2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të 25 Maj” në fshatin Lubinje e poshtme, komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi M.M. është në marrëdhënie pune-mësimdhënës pranë kësaj shkolle dhe i njëjti për vitin 2021/22, dhe atë nga data 19.04.2021 e deri me datë 22.11.2022, ka punuar gjithsej 272 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekura, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimit të lartcekur SHFMU gjykata ia fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e punës për paditësit M.M. për vitin 2021/22, dhe atë nga data 19.04.2021 e deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 271 ditë pune.

+

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “*Të punësuarve (antarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...*”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese si në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*” dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve për këtë pjesë është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit, neni 35 paragrafi 7, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese për kërkesën e paditësit që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të shujtave për datën 22.11.2022, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore, si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi dhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”. Kjo duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, GJ.A-Su. A 214/2023, të datës 09.10.2023, ku në pikën III, përcaktohet që Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, e lidhur me datë 22.01.2021, e nënshkruar nga Organizatat e të punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës, si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Arsimit,

Shkencës dhe Teknologjisë), aplikohet në periudhën kohore nga data 22.01.2021, e deri me datë 21.11.2022 dhe për këtë arsye kërkesëpadia e paditësit M.M. për kompensimin e shujtës ditore për datën 22.11.2022, në shumë prej 2 euro, refuzohet si e pabazuar.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësve sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**C.nr.280/2024, datë 27.05.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.